Human Resources Administration
Department of Homeless Services
Department of Social Services

Rinovimi i CityFHEPS
Pyetje të shpeshta
(Albanian)

A duhet ta rinovoj CityFHEPS tim?

Po. Duhet të rinovoni subvencionin tuaj CityFHEPS. Do t'ju dërgojmë një kërkesë për rinovim pesë muaj përpara përfundimit të vitit të subvencionit. Kur të merrni kërkesën për rinovim, duhet të na e ktheni dhe:

- Të konfirmoni se banoni ende në apartamentin tuaj CityFHEPS
- Të konfirmoni numrin e anëtarëve të familjes suaj
- Të paraqisni informacion të përditësuar për të ardhurat

Nëse nuk e ktheni kërkesën për rinovim dhe dokumentet mbështetëse brenda afatit të parë, do t'ju dërgojmë një njoftim paralajmërues.

Nëse nuk na dërgoni dokumentacionin e nevojshëm brenda afatit të përcaktuar në njoftimin paralajmërues, nuk do të mund ta përpunojmë kërkesën tuaj për rinovim brenda periudhës prej 30 ditësh përpara përfundimit të vitit të subvencionit. Ju dhe qiradhënësi juaj do të merrni një njoftim përfundimtar për ndërprerjen e subvencionit.

Çfarë ndodh nëse e dorëzoj me vonesë kërkesën për rinovim?

Dërgimi me vonesë i kërkesës për rinovim (pas njoftimit përfundimtar për ndërprerjen e subvencionit) mund të ketë disa pasoja negative. Mund të përfundoni në gjykatën për çështjet e banimit dhe të rrezikoni të humbni banesën tuaj.

Megjithatë, nëse kërkesa juaj e vonuar për rinovim na mbërrin brenda një viti pas përfundimit të vitit të subvencionit, ose edhe më vonë nëse ka një arsye të justifikuar, mund të jemi në gjendje ta rinovojmë ose ta rikthejmë subvencionin.

(Ktheni faqen)

Si ta dorëzoj kërkesën për rinovimin e CityFHEPS?

Dorëzimi në internet përmes ACCESS HRA (AHRA) është mënyra më e lehtë dhe më e shpejtë për të dorëzuar kërkesën tuaj për rinovimin e CityFHEPS.

Dorëzoni formularin tuaj të rinovimit

- Shkoni në www.nyc.gov/accesshra ose përdorni aplikacionin celular ACCESS HRA (AHRA).
- Hyni në llogarinë tuaj ose krijoni një llogari nëse nuk e keni një të tillë.
- Lidhni çështjet tuaja me llogarinë tuaj nëse nuk e keni bërë ende këtë.
- Lëvizni poshtë te **Çështjet aktive dhe aplikimet në proces**.
- Gjeni kartën e çështjes suaj CityFHEPS dhe klikoni butonin "**Rinovo**".
- Plotësoni të gjitha të dhënat për rinovimin dhe dorëzoni formularin tuaj të rinovimit.

Dorëzoni dokumentacionin e kërkuar

Ngarkoni dokumentet në aplikacionin celular AHRA për të vërtetuar çdo ndryshim në rrethanat tuaja të jetesës, si ndryshimet në të ardhura, pasuri, qira, shpenzimet për shërbimet utilitare, numrin e anëtarëve të familjes, shpenzimet për kujdesin ndaj fëmijëve dhe çdo ndryshim tjetër.
Për më shumë informacion: www.nyc.gov/hradocs

Nuk mund ta dorëzoni në internet?

Nëse nuk mund të përdorni AHRA për të na dërguar informacionin ose dokumentet shtesë që ju kemi kërkuar, mund t'i dërgoni kopjet e dokumenteve me email, me postë ose t'i dorëzoni personalisht:

Email: CityFHEPSrenewals@hra.nyc.gov

Dërgojini me postë ose dorëzojini personalisht:
CityFHEPS
NYC Human Resources Administration
109 East 16th Street
New York, New York 10003

Pavarësisht mënyrës së dorëzimit, sapo agjencia të marrë kërkesën tuaj për rinovim, do t'ju konfirmojmë marrjen e saj. Nëse e dorëzoni në internet, që është mënyra më e lehtë dhe më e shpejtë, do të merrni menjëherë konfirmimin e dorëzimit.

(Ktheni faqen)

Çfarë ndodh nëse ndryshon numri i anëtarëve të familjes sime?

Nëse dikush largohet nga familja juaj, shuma maksimale e qirasë për të cilën kualifikohet familja juaj mund të ulet. Nëse kjo ndodh, mund t'ju duhet të zhvendoseni në një apartament të ri me qira më të ulët.

Nëse numri i anëtarëve të familjes suaj rritet dhe banesa juaj bëhet tepër e mbipopulluar, mund të aplikoni për transferim për një arsye të justifikuar në një banesë më të madhe, duke iu drejtuar programit Homebase në zonën tuaj.

Sa të ardhura mund të ketë familja ime?

Familja juaj mund të ketë të ardhura bruto deri në 80% të të ardhurave mediane të zonës (AMI) dhe të kualifikohet ende për rinovimin e CityFHEPS.

A më duhet një kontratë e re qiraje për të rinovuar CityFHEPS?

Nuk ju kërkohet të keni një kontratë të rinovuar qiraje me qiradhënësin për të vazhduar pjesëmarrjen në programin CityFHEPS. Për sa kohë që vazhdoni të kualifikoheni për CityFHEPS dhe rinovoni subvencionin, programi do të vazhdojë.

Si mund ta rris shumën e qirasë që mbulohet nga CityFHEPS?

Nëse qiraja juaj rritet, mund të jemi në gjendje të rrisim subvencionin. Duhet të na paraqisni një kontratë të re qiraje të nënshkruar, me shumën më të lartë të qirasë. Na e dorëzoni kontratën e re të qirasë kur të dërgoni formularin tuaj të rinovimit. Nëse jeni zhvendosur në apartamentin tuaj përpara janarit 2022, na dorëzoni edhe formularin e plotësuar të informacionit të qiradhënësit për shërbimet utilitare.

Çfarë është formulari i informacionit të qiradhënësit për shërbimet utilitare dhe pse i nevojitet HRA-së?

HRA nuk do të paguajë shumën e parashikuar për një apartament me shërbime utilitare të përfshira nëse qiradhënësi juaj nuk ofron disa ose të gjitha këto shërbime. Qiradhënësit duhet të plotësojnë formularin e informacionit të qiradhënësit për shërbimet utilitare për të njoftuar HRA-në se cilat shërbime utilitare ofrojnë, nëse ofrojnë ndonjë.

(Ktheni faqen)

Çfarë janë kompensimi dhe pagesa për shërbimet utilitare?
Shpenzimet për çdo shërbim utilitar që paguhet nga qiramarrësi do të zbriten nga shuma e subvencionit që HRA do t'i paguajë qiradhënësit. Shuma që zbritet quhet "kompensim për shërbimet utilitare". Nëse disa ose të gjitha shërbimet utilitare nuk përfshihen në qiranë tuaj dhe qiraja juaj është më e ulët se shuma maksimale e lejuar, do të merrni një kompensim për këto shërbime utilitare. Kompensimi për shërbimet utilitare bazohet në koston tipike të shërbimeve utilitare dhe shërbimeve të tjera që paguajnë familjet në banesa me madhësi të ndryshme.

Nëse kompensimi juaj për shërbimet utilitare është më i lartë se pjesa e pagesës që i takon familjes suaj, çdo shumë e mbetur do t'ju dërgohet me postë, në mënyrë që t'i përdorni këto para për të paguar drejtpërdrejt shërbimet tuaja utilitare. Kjo shumë quhet "pagesë për shërbimet utilitare".

Për më shumë informacion, vizitoni faqen e internetit të DSS për CityFHEPS në https://www.nyc.gov/site/hra/help/cityfheps-documents.page.

Për sa kohë mund të përfitoj nga CityFHEPS?
Mund të përfitoni nga CityFHEPS për gjithsej pesë vjet. Kjo përfshin çdo periudhë gjatë së cilës mund të keni marrë pagesa nga programet e mëparshme të ndihmës për qiranë (CITYFEPS, LINC, SEPS ose Pathway Home).

Ky kufi prej pesë vjetësh nuk zbatohet për të gjitha familjet. Nëse familja juaj përfshin një person 60 vjeç e lart ose një të rritur që merr përfitime federale për aftësinë e kufizuar, nuk ka kufizim kohor. Gjithashtu, në rrethana të caktuara, mund ta zgjasim subvencionin tuaj përtej kufirit prej pesë vjetësh për një arsye të justifikuar.

Kur t'i afroheni kufirit prej pesë vjetësh, do t'ju dërgojmë me postë një kërkesë për rinovim për një arsye të justifikuar.

Rinovimet kushtëzohen gjithmonë nga përmbushja e vazhdueshme e kritereve të kualifikimit nga familjet dhe nga disponueshmëria e vazhdueshme e fondeve.